





Të reja ▾

Kush jemi ▾

Historiku

Shërbime ▾

Baza ligjore

Vendndodhjet

Video

Programi i transparencës ▾

Kontakt

Denonco Krimin Kibernetik

Drejtoritë Vendore ▾

Policia Kufitare ▾

Policia Rrugore ▾

Donacione

Policimi në Komunitet

Përmbledhja Mujore

Për sinjalizimin

Të Guximshëm pa Armë

Breaking News:

Fier/Shërbimet e Policisë, në ndihmë të banorëve në zonën e përfshirë nga zjarri





05/07/2026

Vau i Dejës/Finalizohet Operacioni I Koduar “Remote”

Vau i Dejës / Policia parandalon një ngjarje të mundshme kriminale.

Finalizohet operacioni policor i koduar “Remote”.

Vihet në pranga një 38-vjeçar, i cili u kap duke transportuar një minë me telekomandë, të lidhur me një aparat celular për shpërthim në distancë.

Shpallet në kërkim një 34-vjeçar, i dyshuar si bashkëpunëtor i 38-vjeçarit.

Sekuestrohen, në cilësinë e provës materiale, një minë me telekomandë, një automjet, një maskë dhe dy telefona celularë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Vau i Dejës, në bashkëpunim me Sektorin për Hetimin e Krimeve të Rënda të DVP Shkodër, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative se një shtetas po transportonte një minë me telekomandë, kanë organizuar menjëherë ndërhyrjen, duke parandaluar një ngjarje të mundshme kriminale.

Rreth orëve të para të mëngjesit, në fshatin Stajkë, u ndalua për kontroll automjeti me të cilin lëvizte i dyshuari. Gjatë kontrollit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një minë me telekomandë, të lidhur me një aparat celular për shpërthim në distancë. Gjithashtu, u sekuestruan automjeti, një maskë dhe dy telefona celularë.

Në përfundim të veprimeve të para procedurale, u vu në pranga shtetasi E. B., 38 vjeç, banues në Spitallë, Durrës.

Gjithashtu, u shpall në kërkim shtetasi E. P., 34 vjeç, banues në Durrës, i dyshuar si bashkëpunëtor në këtë rast.

Nën drejtimin e Prokurorisë, vijnë veprimet hetimore për sqarimin dhe dokumentimin e plotë ligjor të rastit, përcaktimin e destinacionit dhe qëllimit të transportimit të minës, si dhe identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë që mund të jenë të përfshirë.



Vau i Dejës/Finalizohet operacioni i koduar "Remote"

Policia e Shtetit



Watch on

◀ Rezultatet kryesore të strukturave policore në vend dhe ngjarjet e ndodhura gjatë 24 orëve të fundit.

Fier/Shërbimet e Policisë, në ndihmë të banorëve në zonën e përfshirë nga zjarri ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)